



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë 18.03.2025
Numër Protokolli: 1948/2025

A.nr.1880/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1880/2024 të datës 10.12.2024 të parashtruar nga ankuesi N.B, kundër Ministrisë së Ekonomisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1180/2024, e datës 10.12.2024, e parashtruar nga ankuesi, N.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 08-6721/1 i datës 11.11.2024, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit më numër të referencës RN00015007.

A r s y e t i m

Ankuesi N.B, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 10.12.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015007, gjegjësisht për pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, i shpallur më datë 09.09.2024 nga Ministria e Ekonomisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,

ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1035/2025 të datës 27.02.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6592/2024, të parashtruar nga ankuesi më datë 10.12.2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Konkursin me numër reference RN00015007 të datës 09.09.2024; Konkursin me numër reference RN00010828 të datës 25.01.2023; Vendimin me numër protokolli 3229 të datës 29.03.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 15.01.2025; Miratimin e përshkrimit të detyrave të punës; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin e datës 30.10.2024; Njoftimin e datës 21.10.2024; Formularët e vlerësimit të eses të datës 28.10.2024; Orarin e intervistës me gojë; Pyetjet e intervistës me gojë; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 11.11.2024; Njoftimin me numër protokolli 5721/1 të datës 11.11.2024; Testet me shkrim të kandidatëve të datës 28.10.2024; Pyetjen e prezantimit dërguar kandidatëve për pranim; Aplikacionin e kandidatit A.K. së bashku me dokumentacionin e dorëzuar më datë 09.10.2024; Aplikacionin e ankuesit, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar më datë 24.09.2024; Aplikacionin e kandidatit S.B, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar më datë 01.10.2024; Aplikacionin e kandidatit SH.M, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar më datë 03.10.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Ekonomisë, më datë 09.09.2024, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00015007, për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*” në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me afat aplikimi nga data 10.09.2024 deri më datën 09.10.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë, prej tyre vetëm pesë (5) kandidatë e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili nga vlerësimi profesional ka arritur gjithsejtë 53.2 pikë nga kjo procedurë rekrutimit, të pamjaftueshme për tu shpallur kandidatë fitues.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë më datë 11.11.2024, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 6721/1, nga i cili njoftim rezulton se procedura e rekrutimit

me numër reference RN00015007, për pozitën e punës “*“Drejtor Ekzekutiv”*” në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, ka përfunduar, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur mbi 70 % të pikëve totale të vlerësimit.

Ankuesi, ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vet shpalljes së konkursit të datës 09.09.2024, kundër përbërjes së komisionit si dhe njoftimit të datës 11.11.2024, mbi pretendimet ankimore për anulimin dhe ri shpalljen e konkursit të sipër theksuar, duke siguruar respektimin e standardeve të transparencës dhe meritokracisë, duke kërkuar nga Këshilli si organ më i lartë i cili monitoron institucionet e administratës publike, të merr parasysh këtë ankesë dhe të rishqyrtoj mbarëvajtjen e përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të SHGJK-së

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN0001007, respektivisht për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë, **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 8 (tetë) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijim: - pesë (5) vite përvojë pune në pozitat drejtuese, ose katër (4) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose tri (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës), nga rezulton se shpallja e konkursit, përshkrimi i detyrave të punës dhe përcaktimi i kërkesave të përgjithshme formale për këtë pozitë pune është në pajtim me Shtojcën Nr.1/1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë, të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Tutje, në shqyrtim e sipër të pretendimeve të ankuesit, Kolegji i Këshillit, i’u referuar dispozitave ligjore që përcaktojnë përbërjen dhe përzgjedhjen e Komisionit të pranimit për kategorinë e lartë drejtuese., përkatësisht nenit 48 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni shtetëror i pranimit. 2. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion tjetër shtetëror, bëhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Komisioni shtetëror i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese në administratë shtetërore, apo komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 3.1. tre (3) nëpunës/ës ekzistues në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese; 3.2. udhëheqësen/in e njësisë përgjegjëse; 3.3. një (1) eksperte/t i jashtëm., rrjedhimisht Kolegji ka analizuar Vendimin me Nr.03/224 të datës 11.10.2024, mbi të cilin akt Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka themeluar Komisionin e

Pranimi për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese Drejtor Ekzekutiv në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, i cili rezulton se ishte në këtë përbërje: *A.K- kryesuese, e cila mbanë pozitën e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë; F.D- anëtare, e cila mbanë pozitën e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; V.Ç- anëtare e cila mbanë pozitën Sekretare e Përgjithshme Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; F.M-K- anëtare, e cila mbanë pozitën e Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, si dhe E.S, anëtarë në cilësinë e Ekspertit të Jashtëm.*, ashtu që me këtë rast pretendimi ankimor i ankuesit se asnjë anëtar i komisionit të pranimi nuk është i fushës së Gjeologjisë, është i pa qëndrueshëm ngase sipas këtyre dispozitave ligjore nuk parashihet kjo kërkesë e pretenduar nga ankuesi, mirëpo përcaktohet kompetenca e themelimit dhe përbërja e këtij Komisioni për këtë pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, që faktikisht është në pajtim me këto përcaktime ligjore si dhe me nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshilit, nga analizimi i shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në paragrafët 7, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 47 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, ku përcaktohet se: *7. Vlerësimi profesional i kandidatëve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve/ëve si dhe intervistë me gojë. 8. Të gjithë kandidatët/ët e vlerësuar nga komisioni i pranimi mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë/at fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 9. Lista e kandidatëve/ëve fitues i dërgohet mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë dhe bëhet publike nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme informimi. 10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. 11. Në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidatë/at fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedurë e re rekrutimi.*, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *1. Të gjithë kandidatët e vlerësuar nga komisioni i pranimi mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatët fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendim të arsyetuar përzgjedh kandidatin fitues të propozuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja e fituesve....; si dhe nenit 10A të Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve në kategorinë e lartë drejtuese pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në pesëdhjetë (50) pikë. Hartimi/përzgjedhja e pyetjeve bëhet në përputhje me paragrafin 5 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. 4. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzetepesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me një (1) pikë,*

ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetepesë (25) pikë. 5. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 6. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 7. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 8. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim. 9. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që i janë nënshtruar testimit me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 10. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 11. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 12. Intervista bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti pesë (5) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 15 pikë. 13. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 14. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti pesëdhjetë (50) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 15. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 15.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 15.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 15.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 16. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve, rrjedhimisht duke qenë kandidati A.K, ka arritur gjithsejtë 69.2 pikë, kandidati Sh.M ka arritur gjithsejtë 62.4 pikë, ankuesi ka arritur gjithsejtë 53.2 pikë si dhe kandidati S.B ka arritur gjithsejtë 50.8 pikë, nga kjo procedurë rekrutimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, me rastin e nxjerrjes së Njoftimit me numër protokolli 6721 të datës 11.11.2024, ku si rezultat ka përfunduar pa procedurën përkatëse të rekrutimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e sapo theksuara ligjore, ngase asnjëri nga kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë rekrutimi, nga vlerësimi profesional i testit me shkrim dhe intervistës me gojë nuk kanë arritur mbi 70% të pikëve totale, ndërsa faktikisht procedura e rekrutimit për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese duhet të përfundojë me dy kandidatë fitues apo më shumë se 70% të pikëve të përgjithshme.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1880/2024

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit N.B;*
- *Udhëheqëses së Njësië për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*